



## Migrationsamt (Zyra e Imigracionit)

# FAQ (Pyetje të shpeshta) Karta e identitetit e nënshtetasve të huaj në formatin e një karte krediti

- **Si ndryshon karta e identitetit për nënshtetasit e huaj, e lëshuar nga BE/EFTA, nga ajo për nënshtetasit e vendeve të treta?**

Karta e identitetit për nënshtetasit e huaj nga EU/EFTA është një e ashtuquajtur kartë identiteti jobiometrike. Kjo do të thotë që karta e identitetit **nuk** përmban një çip të dhënash, dhe në kartë shfaqen vetëm fotografia e fytyrës si dhe firma.

Karta e identitetit për nënshtetasit e vendeve të treta ka një çip të dhënash ku ruhen elektronikisht edhe imazhi i fytyrës, shtypjet e gishtave dhe firma.

- **Kush do të marrë një kartë të re identiteti biometrike për nënshtetasit e huaj?**  
Vetëm nënshtetasit e vendeve të treta me një lejë qëndrimi tip L, G, B ose C. Ata me lejë qëndrimi tip F ose N nuk do të marrin një kartë të këtillë.
- **A mund të aplikoj edhe për një pasaportë biometrike, edhe pse ajo aktuale që kam ende mbetet e vlefshme?**  
Jo. Karta aktuale e identitetit mbetet e vlefshme deri në datën e skadimit.
- **Si të mësoj nëse duhet regjistrimi biometrik?**  
Nëse nevojitet, ju mund të lini një takim me Zyrën ID Canton St.Gallen për regjistrimin e të dhënave tuaja biometrike.
- **Sa kushton regjistrimi biometrik dhe si mund të paguhet?**  
Regjistrimi biometrik kushton CHF 20.00 për frymë (para në dorë, EC/Karta PostFinance/kartat e kreditit, TWINT). Kostot e prodhimit të kartës së identitetit për nënshtetasit e huaj urdhërohen veç e veç nga zyra e regjistrimit të banorëve.
- **A do të mbetet e vlefshme karta ID ime e shtypur pas hyrjes së sistemit të ri më dt. 2 Mars 2020?**  
Kartat ID aktuale prej letre vazhdojnë të jenë të vlefshme deri në datën e skadimit.
- **Kam dëshirë ta zëvendësoj sa më parë kartën ID time prej letre me një kartë ID me format prej karte krediti. A do të zëvendësohen përgjithësisht?**  
Një kartë e re e këtillë do të lëshohet vetëm nëse bëhet ndonjë ndryshim që ka të bëjë me kartën, p.sh. ndryshimi i emrit, shpërngulja nga një kanton tjetër ose një zëvendësim. Një kopje mund të lëshohet vetëm **me pagesë** nëse karta është e humbur (kjo duhet t'i bëhet e ditur policisë) ose nëse dëmtohet plotësisht.
- **Ku do të regjistrohen të dhënat e mia?**  
Fotografia dhe firma juaj regjistrohen në zyrën e kartave të identitetit tek adresa Oberer Graben 32, 9001 St.Gallen. Në rastin e nënshtetasve të vendeve të treta të cilëve u lëshohen karta biometrike identiteti për të huajt, regjistrohen dy shtypje gishtash si dhe fotografia e fytyrës dhe firma, të cilat ruhen pastaj në çipin e të dhënave të kartës së identitetit.



- **A mund të porosis regjistrimin e të dhënave të mia pa takim të prenotuar?**  
Jo. Pa ftesë paraprake për një takim të tillë, nuk mund të mblidhen aspak të dhënat.
- **A ka mundësi të shtyhet takimi për mbledhjen e të dhënave?**  
Mbledhja e të dhënave në përgjithësi është e detyrueshme dhe e nevojshme në mënyrë që të mund të lëshohet karta e identitetit e nënshtetasit të huaj. Si rregull, shtyrja e takimit do të vonojë lëshimin e kësaj karte. Kapacitetet e zyrave të kartave të identitetit janë të kufizuara dhe ndryshojnë sipas luhatjeve sezonale. Një takim mund të shtyhet njëherë nëpërmjet internetit me anë të kodit QR ose kodit të aksesit në letrën e ftesës për takimin. Nëse shtyrja bëhet e pashmangshme për arsye të rëndësishme, një takim tjetër mund të kërkohet duke thirrur Zyrën ID me nr. tel. 058 229 88 77.
- **Çfarë duhet të sjell me vete për mbledhjen e të dhënave?**  
Letra e ftesës për takimin (AVIS) ose emaili me hollësitë e pikëpjekjes suaj, pasaporta ose karta juaj aktuale e identitetit (për identifikim), nëse nevojitet, CHF 20 për frymë për regjistrimin biometrik si dhe karta juaj e vjetër e identitetit për të huajt. Pa pasaportë ose kartë identiteti, të dhënat nuk mund të regjistrohen, dhe do t'ju duhet një takim tjetër!
- **A do të më duhet t'i regjistroj sërish të dhënat sa herë që ndërroj kartën time ID?**  
Jo. Fotografia e fytyrës dhe firma juaj ruhen për pesë vjet dhe mund të ripërdoren brenda kësaj periudhe kohe.
- **Ku do të dërgohet me postë karta e re e identitetit për mua si nënshtetas i huaj?**  
Karta e re e identitetit i dërgohet zakonisht drejtpërsëdrejti adresës suaj të regjistruar.
- **Ku mund të gjej më shumë informacion?**  
<http://www.migrationsamt.sg.ch> ose <http://www.ausweisstelle.sg.ch>
- **Kë të kontaktoj nëse kam më shumë pyetje?**  
Ju lutemi dërgojani një email [migrationsamt@sg.ch](mailto:migrationsamt@sg.ch) ose na kontaktoni me telefon me nr. 058 229 31 11.